

STRATEGJIA MARKETING

Marketingu në ekonominë e sotme

Më me rëndësi është të veprohet çfarë është strategji e drejtë se sa çfarë është momentalisht fitimprurëse.

Filip Kotler

Gjatë një betejë të furishme kundër turqve që zgjati përtej muzgut, Skënderbeu urdhëroi disa nga ushtarët e tij të gjenin një tufë me dhi, e u lidhën pishtarë të ndezur brirëve të tyre dhe dërgohen në drejtim të rreshtave të ushtarëve turq gjatë natës. Turqit besuan se u sulmuan nga trupa të shumta shqiptare dhe u larguan me mendimin se u mundën që në numër.

<http://sq.wikipedia.org/wiki/Skënderbeu//> legjenda

Hyrje

Të konkurrosh në ekonominë e sotme do të thotë gjetja e rrugëve dhe mënyrave për të shmangur inferioritetin dhe për të njohur nevojat e konsumatorëve më mirë se ndërmarrjet konkurruese. Të gjitha ndërmarrjet si ato fitimprurëse edhe ato jofitimprurëse, kërkojnë planifikim efektiv dhe një strategji të shëndoshë të marketingut për ta bërë këtë në mënyrë efektive. Pa këto përpjekje ndërmarrja nuk do të jetë në gjendje për të kënaqur konsumatorët apo për të identifikuar nevojat e tyre. Fuqia dhe mirëqenia e një kompanie është e lidhur ngushtë me aftësinë e saj të rekrutojë, kënaq bile edhe ti admiroj konsumatorët. Përderisa fokusi në konsumatorët dhe orientimi drejt tregut janë shumë të rëndësishme dhe praktikohen nga organizatat, funksioni i marketingut është më së shumti përgjegjës për të siguruar kënaqësinë e konsumatorëve.

Për shembull, duke pasur një strategji efektive të marketingut Apple zhvilloi produkte shumë të kërkuara si iPhone, iPod, MacBook dhe linjën e mini kompjuterëve. Planifikimi dhe strategjia efektive e marketingut i mundësoi menaxhmentit të kompanisë Cola-Cola për të vazhduar me prodhimin e pijeve të buta dhe i bëri zgjedhjen më të rëndësishme në blerjen e markës së Vitamin Water, duke vazhduar zgjerimin e saj në tregun fitimprurës kinez. Këto dhe ndërmarrjet tjera përdorin strategji të shëndosha të marketingut për të forcuar anët e forta dhe kapitalizmin apo përpunimin e anëve të dobëta që ekzistojnë në treg. Çdo ndërmarrje, që nga restoranti juaj i preferuar e deri te korporatat shumëkombëshe gjigante, nga qyteti, regjioni dhe qeveria qendrore e deri te organizatat me karakter bamirësie, si Nena Tereze apo Habitati për qëllime humanitare dhe Kryqi i Kuq Kosovar, zhvillojnë dhe implementojnë strategjitë e marketingut. Fokusi i këtij libri qëndron në atë se si këto ndërmarrje planifikojnë, zhvillojnë dhe implementojnë strategjitë e marketingut. Për të arritur këtë fokus, ne ofrojmë një proces sistematik për zhvillimin strategjisë së marketingut të orientuar kah konsumatori dhe planifikimin e marketingut në përputhje me faktorët e brendshëm dhe të jashtëm. Qasja jonë fokusohet në njohuritë e përgjithshme dhe reale të metodave praktike të planifikimit të marketingut, duke përfshirë edhe procesin dhe zhvillimin e një plani të marketingut. Kapitujt e këtij libri përqendrohen në hapat e këtij procesi. Qëllimi ynë është që t'i japim lexuesit njohuri më të thella për planifikimin e marketingut,

aftësinë për të organizuar, sasi më të madhe të informacionit të nevojshëm për të kompletuar procesin e planifikimit dhe një "ndjeshmëri" aktuale për zhvillimin e planifikimit të marketingut.

Në kapitullin e parë, ne do të shqyrtojmë disa nga sfidat më të mëdha dhe mundësitë që ekzistojnë në fushën e planifikimit të strategjisë së marketingut në ekonominë e sotme. Gjithashtu do të shqyrtojmë natyrën dhe qëllimin e aktiviteteve kryesore të marketingut dhe vendimet që ndodhin në të gjithë procesin e planifikimit. Së fundi, ne paraqesim disa nga sfidat më të mëdha të përfshira në zhvillimin e strategjisë së marketingut.

Duke filluar nga sot, ju jeni një brand (emër, markë) njejtë sikur Nike, Coca-cola, Pepsi apo AAB... filloni të mendoni sikur të ishit menaxheri i markës tuaj të preferuar dhe pyeteni veten tuaj... Çfarë vetish ka në produktin apo shërbimin tim që më bën ndryshe?... Filloni me identifikimin e kualiteteve apo të karakteristikave që ju bën të dallueshëm nga konkurrenca apo kolegët tuaj...Çfarë do të thonin kolegët tuaj për përparësinë tuaj më të fortë? Për karakteristikën tuaj më të çmueshme?

-- Tom Peters "The Brand Called You," In Fast Company, shtator 1997

Sfidat dhe Mundësitë e Marketingut në Ekonominë e sotme

Idetë tradicionale në lidhje me strategjinë e marketingut filluan të ndryshojnë përgjithmonë gjatë mesit të viteve të 90-ta. Përparimet në kompjuteristikë, komunikim dhe teknologji të informacionit përgjithmonë ndryshuan botën dhe mënyrën se si tregtarët i synojnë klientët potencial. Në praktikën e marketingut dhe biznesit dhe për vetë sjelljen tonë personale mbi blerjen, duhet marrë parasysh këto ndryshime themelore:

Zhvendosja e pushtetit tek konsumatori. Ndoshta ndryshimi i vetëm më i rëndësishëm gjatë dy dekadave të fundit është ndryshimi në pushtet nga ofertuesit tek konsumatorët. Në vend se bizneset të kanë aftësi për të manipuluar konsumatorët nëpërmjet teknologjisë, shpeshherë bizneset janë manipuluar nga klientët për shkak të qasjes së tyre në informacione, aftësisë për të krahasuar çmimet, dhe kontrolli që ata kanë

mbi shpenzimet. Konsumatorët individualë dhe klientët e biznesit mund të krahasojnë çmimet dhe specifikimet e produktit për pak minuta. Në shumë raste, konsumatorët janë në gjendje për të vendosur çmimet e tyre, të tilla si për blerjen e biletave ajrore në Kosova Airlines. Përveç kësaj, konsumatorët tani mund të bashkëveprojnë me njëri-tjetrin siç është rasti i „Shoqatës së konsumatoreve“ ku i lejojnë konsumatoreve të japin opinione mbi cilësinë e produktit dhe besueshmërinë furnizuesit. Përderisa pushteti vazhdon të zhvendoset tek konsumatorët, tregtarët kanë pak zgjedhje për t’u siguruar që produktet e tyre janë unike dhe të kualitetit të lartë, duke i dhënë konsumatorëve një arsye për të blerë produktet e tyre dhe të mbeten besnik.

Rritja masive në përzgjedhjen e produktit. Shumëllojshmëria e mallrave dhe shërbimeve të ofruara për shitje në internet dhe në dyqane tradicionale është tronditëse.

Vetëm në dyqanet ushqimore, konsumatorët janë të ballafaquar me opsione të panumërta të produkteve nga drithërat dhe nga pijet e gazuara. Rritja e shitjeve me pakicë në linjë online, lejon konsumatorëve për të blerë një makinë nga <http://www.merrjep.com>, punime dore, dhurata ekzotike, patundshmëri etj. Rritja e efikasitetit të transaksioneve lejon konsumatorët



Konsumatorët kanë qasje të paprecedentë në zgjedhjen e mallrave dhe shërbimeve në ekonominë

për të përmbushur nevojat e tyre më lehtë dhe në mënyrë më të përshtatshme se kurrë më parë. Për më tepër, vëllimi i madh i informacionit online në dispozicion ka ndryshuar mënyrën se si komunikojmë ndërmjet veti, se si i lexojnë lajmet dhe si e argëtojmë veten. Kjo rritje nga aspekti i përzgjedhjes së produkteve dhe disponueshmërisë së tyre ka detyruar tregtarët të ngritin rezultatet krahas konkurrencës në çdo cep të globit.

Audienca dhe segmentimi i medieve. Ndryshimet në përdorimin e medias dhe disponueshmërinë e medieve të reja, kanë detyruar marketerët apo ofertuesit që të rishikojnë mënyrën e komunikimit me klientët potencial. Me përhapjen masive të televizionit kabllor në vitet e 70-ta të shekullit të kaluar, audienca e medias është bërë gjithnjë e më e segmentuar.

Teksti i shkruar, fotografit levizëse (filma) dhe tingujt, paraqesin tre mjetet e njoftimit nëpërmjet të cilëve bëhet e mundur shpërndarja e dijes drejt një pluraliteti marrësish ose shfrytëzuesish të informacioneve pa dallim, në përmasa të mëdha duke përdorur mjete të ndryshme, varësisht nga koha, vendi dhe audienca në dërgimin dhe shkëmbimin e ofertave që kanë vlera për klientët, partnerët dhe shoqërisë në përgjithësi. Ky është marketingu medial.

Kur rritja e shfrytëzimit të internetit, radios

satelitore dhe komunikimit celular, është shtuar në këtë mix, bëhet gjithnjë e më vështirë për marketerët për të arritur një audiencë të vërtetë masive. Audienca e medias është segmentuar për shkak të :

- a. numrit të madh të zgjedhjes së medieve që kemi në dispozicion sot dhe
- b. kohës kufizuar që kemi për t'i kushtuar cilëndo media.

Sot, konsumatorët gjithnjë e më shumë marrin informacion dhe lajme nga Facebook, Hi5, Tagget dhe Twitter se sa nga Koha Ditore, Kosova Sot apo Kosovarja dhe Teuta. Ata shpenzojnë një sasi në rritje të kohës në internet se sa për të lexuar revista apo për të shikuar televizion. Siç tregohet në skemën 1.1, përdorimi i konsumit të medieve tradicionale është në rënie ndërsa përdorimi i medieve jo tradicionale si rrjeti social dhe mediet celulare është në rritje. Megjithatë, pavarësisht nga sfida për të arritur një klientelë më gjerë, sot segmentimi i medieve ka një përparësi të madhe, ai është më i lehtë për të përfituar audiencë më të vogël por më të rëndësishme dhe e cila është më e vlefshme për qëllimet specifike të marketingut.

Ndryshimet në Vlerat e ofruara. Edhe para fillimit të "recesionit të madh" në vitin 2008, konsumatorët individual dhe biznesor, tashmë po përballen me kostot në rritje lidhur me energjinë, benzinën, ushqimin dhe produktet tjera të domosdoshme. Pastaj, me dobësimin e ekonomisë blerësit u detyruan të "shtrëngojnë rripat" dhe të kërkojnë mënyra

të tjera për uljen e shpenzimeve. Kjo prirje e vërtetë filloi pas rënies së shënuar dhe konsumatorët filluan që për herë të parë të anashkalojnë disa lloje të firmave dhe të bëjnë gjërat për veten e tyre. Për shembull, agjentët e udhëtimit dhe agjentët e pasurive të patundshme janë goditur rëndë nga tregtimi elektronik. Shumë konsumatorë tani drejtohen për ndihmë te <http://www.merrjep.com/> dhe www.gjirafa.com, sesa te agjentët e udhëtimit për prenotim të biletave ajrore, lundrim ose qëndrime nëpër hotele. Një ndryshim i ngjashëm ka ndodhur në industrinë e pasurive të patundshme sepse blerësit janë duke tjetërsuar shtëpitë e tyre duke hulumtuar në internet, ndërkohë që shitësit janë gjithnjë e më shumë duke përdorë mënyrën "për shitje nga pronari". Si pasojë, shumë tregtar mësuuan një mësim të vështirë. Në situata ku klientët i shohin mallrat dhe shërbimet si produkte, ata do të kthehen në alternativa më të përshtatshme dhe më pak të shtrenjta. Sot, shumë prej këtyre konsumatorëve të ngjashëm, përballen me shkurtime të pagesave ose humbje të punës së tyre, të ndikuara nga rritja e shpenzimeve. Këto dhe vështirësitë e tjera ekonomike kanë detyruar konsumatorët individual dhe konsumatorët biznesor që të ri mendonin lidhur me vlerat e ofruara dhe të përqendrohet në rëndësinë e kursimit. Efektet mbi biznesin kanë qenë dramatike. Një dukuri e ngjashme po ndodh në segmentin e shitjes me pakicë të librit. Po ashtu, futja e Amazon's Kindle dhe Barnes & Noble me libra elektronik i bën lexuesit që të lëshojnë skenën e shitjes me pakicë të librit dhe shtypjen e librit. Për shkak se librat janë bërë shumë të komercializuara, konsumatorët në mënyrë tipike kërkojnë për çmime më të ulëta se sa përfitimet shtesë të ofruara nga libraritë tradicionale. E-libër lexuesit shtojnë se kështu kursejnë hapësirë dhe letër. Kjo është esenca e të qenit kursyes, klientët shikojnë për mënyra të zvogëlimit të shpenzimeve në pjesë të panevojshme të jetës së tyre.

Zhvendosja e modeleve të kërkesës. Në disa raste, ndryshimet në teknologji kanë zhvendosur kërkesat e konsumatorëve për kategori të caktuara të produktit. Lajmet, janë një shembull i mirë, ku gazetatat tradicionale janë zhdukur dalëngadalë kur filluan të rriten lajmet në internet dhe ato celulare. Tani shumë kompani kanë braktisur gazetatat dhe disa janë në prag të braktisjes, përderisa të tjerët kanë zvogëluar botimet për vetëm pak ditë në javëⁱ. Një shembull tjetër është rritja eksplozive në distribucionin digjital të muzikës dhe videove. Suksesi i Apple, iPod dhe iTunes, YouTube, dhe Netflix, së bashku me integrimin e vazhdueshëm të televizionit dhe kompjuterëve, ka ndryshuar në mënyrë

dramatike kërkesën për industrinë e filmit dhe incizimit. Studiomet filmike të Hollywood-it janë ndeshë me kërkesën e zvogëluar në teatro dhe popullaritetin në rënie të konsumatorëve për DVD dhe gjithnjë janë duke hulumtuar për opsionet e filmit online ose për forma të tjera të argëtimit të tilla si video lojrat.

Privatësia, sigurimi dhe shqetësimet etike. Ndryshimet në teknologji e kanë bërë shoqërinë tonë shumë më të hapur se në të kaluarën. Si rezultat, këto ndryshime i kanë detyruar ofertuesit për të adresuar shqetësimet reale për sigurinë dhe privatësinë në të dyja anët, si online ashtu edhe offline. Bizneset gjithmonë kanë mbledhur informacione rutinore në lidhje me klientët e tyre. Konsumatorët janë shumë më të përshtatur me këto përpjekje dhe qëllimet për të cilat informata do të përdoret.

Megjithëse konsumatorët vlerësojnë lehtësinë që u ofrohet nga e-commerce, ata dëshirojnë garancion që informacioni i tyre është i sigurt dhe konfidencial. Shqetësimet mbi privatësinë në internet dhe të sigurisë janë veçanërisht kritike në lidhje me bizneset kontroverze siç janë kazino.

Juridiksioni i paqartë ligjor- Kur një kompani bën biznes në më shumë se një vend (si shumë firma të internetit), kompania shpesh përballet me një dilemë në lidhje me sistemet e ndryshme ligjore. Sot ky ndryshim është veçanërisht i mprehtë për firmat që bëjnë biznes në Shtetet e Bashkuara dhe Kinë. Për shembull, Gogle ballafaqohet me situatë të vështire duke u marrë me kërkesat e censuruara të qeverisë Kineze. Edhe pse Gogle është firmë e Shteteve të Bashkuara, duhet të përputhet me kërkesat kineze duke implementuar një shërbim të ndarë kërkimi që i censuron informatat e konsideruara si të ndjeshme nga qeveria Kinezeⁱⁱ. Për të bërë biznes në Kinë është gjithashtu një çështje me respekt për mbrojtjen e të drejtave intelektuale të pronësisë ku ligji kinez nuk e ofron të njëjtën mbrojtje sikurse në Shtetet e Bashkuaraⁱⁱⁱ. Për shembull prodhuesit e softverave në Shtetet e bashkuara kanë humbur përafërsisht 14 bilion dollar në shitjet e vitit 2007 nga piratëria e softverave në Kinë dhe shtetet tjera aziatike^{iv}.

Një tjetër çështje legale e rëndësishme përfshin mbledhjen e tatimeve në shitje për transaksionet online. Me paraqitjen e tregtisë elektronike shumica e tregtarëve online nuk i kanë mbledhur tatimet e shitjeve për transaksionet online—duke ju dhënë atyre avantazh ndajë tregtarëve të dyqaneve. Megjithatë, shumë tregtar online ende nuk janë ngarkuar me taksat e shitjes. Sot, shumë shtete që ballafaqohen me kolaps ekonomik, janë duke kërkuar për mënyrat që të përforcojnë mbledhjen e taksave të shitjeve për transaksione online.

Konceptet themelore të Marketingut

Marketingu si koncept nënkupton gjëra të ndryshme. Shumë njerëz, veçanërisht ata që nuk janë të punësuar në marketing, e shohin marketingun si një biznes funksional. Nga kjo perspektiv, marketingu gërsheton edhe funksionet e tjera të biznesit si prodhimi, kërkimi, menaxhimi, burimet njerëzore dhe kontabiliteti. Individet tjerë e sidomos ata që punojnë në marketing tentojnë të shohin marketingun si një proces që menaxhon fluksin e produkteve nga një pikë e prodhimit deri te një pikë e konsumit. Organizata e madhe e fushës së tregtisë, Shoqata Amerikane e Marketingut, ka ndryshuar përkufizimin e marketingut në vitin 2005. Nga viti 1985 deri në vitin 2005 AMA e ka përkufizuar marketingun në këtë mënyrë:

Marketingu është një proces i planifikimit dhe ekzekutimit të produktit, çmimit, promovimit dhe shpërndarjes së ideve, mallrave dhe shërbimeve për të krijuar këmbime që kënaqin objektivin individual dhe të organizatës”.

Në vitin 2005, AMA ka ndryshuar përkufizimin e marketingut për të pasqyruar më mirë realitetin e konkurrencës në tregun e sotëm:

Marketingu është një funksion organizativ dhe një seri e proceseve për krijimin, komunikimin dhe shpërndarjen e vlerave për klientët dhe për menaxhimin e marrëdhënieve me klient në mënyrë që të përfitoj organizata dhe konsumatorët e saj”^{vi}.

Të keni parasysh se ndryshimet në definicion nuk janë thjesht të natyrës kozmetike. Definicioni i ri thekson dy faktor të suksesshëm në marketingun e sotshëm: vlerë dhe marrëdhënie të klientëve.

Nocioni i vlerës pranon se kënaqësia e konsumatorëve mund të rrjedhë nga shumë aspekte të ndryshme duke ofruar prodhime të përgjithshme dhe jo vetëm që të kenë qasje të produkteve të kualitetit të lartë me një çmim të ulët.

Marrëdhëniet e konsumatorëve të cilat rriten dhe të lulëzojnë në mënyrë të jashtëzakonshme, janë një domosdoshmëri absolute në statusin e shumë produkteve në treg. Edhe pse përkufizimi i mëhershëm i marketingut ka pasur pa dyshim një fokus transaksional, definicioni i ri thekson një marrëdhënie afatgjatë që siguron vlera për të dyja, për kompaninë dhe për klientin. Mënyra e fundit për të menduar për marketingun ka të bëjë me takimin e nevojave njerëzore dhe shoqërore. Ky pasqyrim i gjerë lidh marketingun me standardin e jetës sonë jo vetëm në aspektin e konsumit dhe prosperitetit por gjithashtu edhe në aspektin e mirëqenies së shoqërisë.

Në saje të aktiviteteve të marketingut konsumatori mund të blejë automjete nga Gjermania, Japonia, Korea Jugore dhe nga Afrika Jugore por edhe organizatat mund të fitojnë një profit të dukshëm dhe t'i bëjnë të gëzuar edhe konsumatorët edhe të punësuarit. Megjithatë marketingu mundet që gjithashtu të krijojë një pasqyrë për efektet negative që mund të gjenerohen. Kjo pasqyrë kërkon që tregtarët të kenë parasysh ndikimet etike dhe shoqërore të aktiviteteve të tyre dhe se a e praktikojnë mirësjelljen duke ia kthyer anasjelltas komunitetit të tyre.

Të shikojmë më konkretisht disa koncepte themelore të marketingut. Siç do të shohim në vijim, ndryshimet në ekonominë e sotme, kanë ndryshuar për gjithmonë mënyrën tonë të menduarit për aspektet themelore të marketingut .

Çka është tregu?

Shiqar nga aspekti më themelor i tij, tregu është një takim i blerësit dhe shitësit. Ne mendojmë për tregun si një grup i individëve ose institucioneve që kanë nevojë të ngjashme dhe që mund të takohen nga produkte të specifikuar. Tregu është një pikëtakim i blerësit dhe shitësit. Për shembull, tregu i shtëpive është një takim i blerësve

dhe shitësve të pasurive të pa tundshme banesore ndërsa tregu i automobilave përfshin blerësin dhe shitësin e automjeteve transportuese. Tregtarët ose shitësit tentojnë që të përdorin fjalën tregtar që të përshkruajnë vetëm shitësin në kuptimin themelor të tregut i cili nuk ka ndryshuar që një kohë të gjatë. Çfarë ka ndryshuar? Edhe pse nuk është ndryshim aq i madh, nga “çka” në “ku” të një tregu, nënkupton një vend të takimit të blerësit dhe shitësit. Në të dy tregjet e konsumit (si të shtëpive dhe të automobilave) edhe tregjet e biznesit (si për pjesë rezervë dhe material të papërpunuar), në pyetjen për “çka” përgjigja shumë shpejt u bë “gjithëshka” dhe në pyetjen për “ku” përgjigja shumë shpejt u bë “çdo kund” pasi që tregjet janë bërë më pak të definuar gjeografikisht.

Deri kohët e fundit, tregtarët i kanë konsideruar tregjet si lokacione fizike ku blerësi dhe shitësi takohen për të kryer transaksionet. Edhe pse këto vende (p.sh. dyqanet ushqimore, qendrat tregtare) ende ekzistojnë, teknologjia ndërmjetëson disa nga tregjet në rritje më të shpejtë. Termi hapësirë e tregut është shpikur për të përshkruar këto sheshe elektronike të pavarura nga koha ose hapësira^{vii}.

Në hapësirën e tregut, mallrat fizike, shërbimet dhe informatat janë shkëmbyer përmes rrjeteve kompjuterike. Hapësirat e tregut ekzistojnë edhe në biznes. Kalimi nga sheshi i tregjeve në hapësirat tregtare ka një degëzim domethënës për tregtarët. Fakti që klientët mund të blejnë, të bëjnë porosi dhe të shkëmbejnë informata 24/7 do të thotë që këto biznese duhet të jenë të afta për të vepruar në atë kornizë të njëjtë kohore. Në fakt, asnjëherë operatorët e hapësirës tregtare kurrë nuk kanë marrë pushime, ato asnjëherë nuk mbyllen. Kjo gjithashtu do të thotë që kompanitë s’duan të humbasin kontrollin mbi informatat që janë shpërndarë rreth kompanisë dhe produkteve të tyre. Përmes ditarëve, forumeve për diskutim apo edhe përmes faqes Facebook apo Twitter, klientët mund të shkëmbejnë informata në lidhje me hapësirën e tregut edhe jashtë hapësirës tregtare. Për më tepër, zëvendësimi i teknologjisë për ndërveprim njerëzor mund të jetë si një bekim dhe një mallkim. Shumë konsumatorë, megjithatë, kanë qenë të ngadaltë për të pranuar hapësirat tregtare sepse këto vende nuk kanë elementin njerëzor. Në këto raste, dizajni dhe zbatimi i përvojës online është një sfidë për operatorët e hapësirave tregtare. Së fundi, begatia e informatës që është në dispozicion nëpërmjet hapësirave tregtare të sotme jo vetëm që e bën konsumatorin më të arsimuar se kurrë më parë, por gjithashtu i

jep edhe fuqi në aspektin e blerjes dhe negocimit të çmimeve. Një tjetër ndryshim interesant në lidhje me tregjet është paraqitja e tregjeve **komplementare** dhe tregjeve **mediatike**.

Një treg komplementar është një grup i mallrave të ngjashme të lidhura ngusht mes vete dhe shërbimeve që janë në qendër të një aktiviteti specifik të konsumit. Një treg mediatik(online) ofron qasje në një pikë të vetme ku blerësit mund të identifikojnë dhe të kontaktojnë shitës të ndryshëm në tregun komplementar^{viii}. Supozojmë, për shembull, që ju jeni të angazhuar rreth blerjeve për martesë. Sa vendime të blerjeve të ndryshme do të bëni ju edhe i fejuari/a i/e juaj në muajt e ardhshëm? Sa reklama, gazeta, faqe të internetit dhe revista do të hulumtoni? Edhe pse bizneset dhe vendimet janë të ndryshme, ata të gjithë kanë një temë të vetme të planifikimit të dasmës. Ky është parimi lëvizës mbrapa një tregu komplementar .

Çka është këmbimi ?

Të ndërlidhura me konceptin e tregut, idetë tona lidhur me këmbimin kanë ndryshuar në vitet e fundit.

Këmbimi është definuar tradicionalisht si proces i kërkimit të diçkaje me vlerë nga dikush i cili kërkon diçka për kompensim. Kjo zakonisht përfshin blerjen e produkteve me para. Për të ndodhë shkëmbimi duhet të plotësohen pesë kushte:

1. **Duhet të jenë të paktën dy palë për shkëmbim.** Edhe pse gjithmonë ka qenë kështu, sot procesi i shkëmbimit mund të përfshijë një numër të pakufizuar të pjesëmarrësve. Ankandet online ofrojnë një shembull të mirë. Çdo pjesëmarrës ndryshon procesin për të tjerët si dhe rezultatin përfundimtar për fituesin e ofertës. Disa ankande përfshijnë sasi të shumta të një artikulli kështu që ekzistojnë kërkesa për transaksionet e shumëfishta brenda një procesi të vetëm të ankandit.
2. **Secila palë ka diçka me vlerë për të ofruar palës tjetër.** Këmbimi do të mund të jetë i mundshëm por jo shumë i pëlqyem pa këtë kusht themelor. Interneti ka ekspozuar për ne një grup të madh të mallrave dhe shërbimeve që ne nuk i kemi ditur që kanë ekzistuar më parë. Sot, jo vetëm që mund të blej një televizion apo një stereo pranues nga një shitës lokal por ne gjithashtu kemi qasje tek qindra shitës online. Gjithashtu aftësia për ti krahasuar produktet që janë në shitje dhe çmimet e tyre i lejojnë konsumatorët që të kërkojnë vlerën më të mirë
3. **Secila palë duhet të jetë e aftë në komunikim dhe shpërndarje.** Avantazhet e komunikimit të sotëm dhe shpërndarjes janë të mëdha. Ne mund të gjejmë dhe të komunikojmë me partnerë potencialë të këmbimit kudo dhe kurdo me anë të telefonit, kompjuterit, televizionit interaktiv dhe telefonave smart. Ne gjithashtu mund të kryejmë transaksionet të lira në kohë reale me shpërndarjen e artikujve të këmbyer që bëhen brenda pak orëve nëse është e nevojshme. Për shembull, ju

mund të dërgoni porosi te Restaurant Centrum gjatë rrugës suaj nga puna për në shtëpi.

4. Secila palë duhet të jetë e lirë për të pranuar ose refuzuar shkëmbimin.

Në situatën e rrjetit online, ky kriter i këmbimit është duke u bërë më i komplikuar. Konsumatorët kanë rritur kërkesat e tyre për lehtësime me të cilat ata mund të kthejnë artikujt te tregtarët lokal. Rregulloret e lehta të kthimit janë një prej fuqive të shumta të tregtarëve tradicional që janë jashtë rrjetit online. Kthimi i artikujve është më i vështirë te transaksionet online. Në disa raste, aftësia për të refuzuar këmbimin nuk është e lejuar në transaksionet online. Me fjalë të tjera, pasi që të filloj procesi aktual i blerjes, konsumatori nuk është i lirë që të refuzoj këmbimin.

5. Çdo palë beson se është e dëshirueshme për të shkëmbyer me palën tjetër.

Konsumatorët zakonisht kanë informata të mëdha në lidhje me tregtarët joonline-jashtë rrjetit, mbase kanë edhe ndonjë ngjarje personale që i lidhë me ta. Në këmbimin online konsumatorët shpesh nuk dinë asgjë për palët tjera. Për të ndihmuar për të zgjidhur këtë çështje, një numër i ndërmarrjeve si palë të treta janë inkurajuar që të sigurojnë klasifikime dhe opinione për shitësit online. Kjo ju jep të dy palëve në procesin e këmbimit një siguri që ekzistojnë individ të respektuar dhe organizatat me reputacion në anën tjetër të transaksioneve.

Arritja minimale është që këmbimi është bërë shumë më i lehtë në ekonominë e sotshme. Konsumatorët nuk kanë nevojë që ti bëjnë telashe vetës për të dhënë kartela të kreditit ose plotësimin e formularit për informata dërguese. Shumë tregtar online do të kuptojnë këtë informatë për neve nëse ne ua lejojmë atyre. Lehtësia me të cilën këmbimi mund të shfaqet sot paraqet një problem te ata individ të cilët nuk kanë aftësi të këmbejnë sepse ende nuk mundën të kompletojnë transaksionet. Kjo është veçanërisht e vërtetë për konsumatorët e mitur.

Çka është produkti?

Produkti nuk duhet të konsiderohet si befasi sepse fokusi kryesor i marketingut është konsumatori dhe mënyra se si organizata mund të dizajnoj dhe të shpërndaj produktet që plotësojnë nevojat e konsumatorëve. Organizatat krijojnë aktivitetet e marketingut si mjet drejt arritjes së këtij qëllimi. Kjo përfshin projektimin e produkteve, çmimin, promocionin dhe shpërndarjen. Shkurtimisht një organizatë nuk mund të ketë arsye të ekzistojë pa konsumatorë dhe pa një produkt për t'iu ofruar atyre. Por çfarë është saktësisht një produkt? Një përkufizim i thjeshtë është se, një produkt është diçka që mund të fitohet me anë të shkëmbimit për të kënaqur një nevojë apo një dëshirë. Ky përkufizim na lejon që të klasifikojmë një numër të gjerë të “gjërave” si produkte^{ix}.

- **Mallrat.** Mallrat janë artikuj të prekshëm që klasifikohen nga ushqimet e konservuara deri te aeroplanët luftarak, nga rekuizitat sportive deri te veshjet e përdorura. Marketingu i mallrave të prekshëm është dëshmuar si një ndër aktivitetet biznesore më të pranuar gjerësisht në botë. Janë mallrat e prodhuara nga kompani të ndryshme të cilat shiten si refuz ashtu edhe si të paketuara. Marketimi i mallrave është i zakonshëm në të gjitha vendet e botës, p.sh. i frigoriferëve, pijeve freskuese, automobilave, etj.
- **Shërbimet.** Shërbimet janë produkte jomateriale të përbërë nga aktet apo veprat e drejtuara ndaj njerëzve apo zotërimet e tyre. Shërbimet janë karakteristike sidomos në vendet e zhvilluara ku përfshijnë veprimtaritë e aviokompanive, agjencive turistike, servisët e automjeteve, hotelet, mirëmbajtjet e ndryshme, por edhe shërbimet profesionale si kontabilistët, bankierët, avokatët, doktorët, IT, kompanitë shpërndarëse të pakove, hotelet, teknikët riparues, dadot, shtëpiakët, konsulentët dhe vozitësit e taksive, të gjithë ofrojnë shërbime. Shërbimet, në vend të mallrave të prekshme, dominojnë ekonominë moderne.

- **Idetë.** Idetë janë nisma e çdo aktiviteti. Çdo kompani ka një ide të cilën përpiqet ta realizoj duke realizuar të hyra për vete. Çdo kampanjë marketingu nisët nga një ide. Dikush mund të ketë një ide për një produkt të veçantë të cilën nuk ka mundësi ta realizoj dhe orientohet te një kompani për ta realizuar bashkërisht për një kompensim financiar. Edhe idetë marketohen. Idetë përfshijnë platformën apo çështjet që synojnë promovimin apo përfitimin për konsumatorët. Disa shembujt tipik që përfshijnë çështjet e idesë janë të lidhura me organizatat bamirësi siç janë Kryqi i kuq i Kosovës, Shoqata Nëna Terezë apo fushata Kosovare e fondacionit kundër duhanit, drogës, Aids etj.
- **Informata.** Edhe informatat gjithashtu mund të shiten si produkte. Universitetet botojnë informacione për studime dhe ato shiten si broshura. Enciklopeditë janë një përmbledhje e informatave të cilat gjithashtu shiten. Revistat për shitblerje të ndryshme si; patundshmëri, automobila të përdorur, makina të përdorura, dhe të ngjashme publikohen dhe shiten për një shumë të caktuar. Udhëzuesit për përgatitje të ushqimeve janë një tjetër produkt i cili përmban informacione për receta të ndryshme dhe shitet në treg. Shkëmbyesit e informatave mbushin faqet e internetit, revistat dhe librat e botuara neper shkolla dhe universitete. Në vitet e digjitalizimit, prodhimi dhe shpërndarja e informatës është bërë një pjesë jetike e ekonomisë sonë.
- **Prodhimet digjitale.** Prodhimet digjitale, siç janë softverat, muzika dhe filmat janë ndër më fitimprurëset në ekonominë tonë. Avancimet në teknologji kanë shkaktuar çrregullime në këto industri, sepse piratët mund të kopjojnë dhe rishpërndajnë produktet digjitale në kundërshtim me ligjin për mbrojtjen e të drejtave të autorit. Produktet digjitale janë shumë interesante për shkak se produktet përmbajnë një licencë të prodhuesit si shërbim plotësues për konsumatorin, që ti përdorin ato në vend të pronësisë së plotë.
- **Njerëzit apo Personat.** Mund të jenë politikanët, muzikantët, yjet e filmit, dhe të gjithë tjerët që dëshirojnë të arrijnë famë personale. Për të gjithë këta persona bëhet marketing. Promovimi individual i njerëzve, siç është rasti me futbollistët e famshëm, xhudistët, është një biznes i madh në mbarë botën. Këmbimi dhe

tregtimi i sportistëve profesional bëhet në një sistem kompleks të drafteve, kontratave dhe agjensioneve të lira. Profesionet e tjera, të tillë si politikanët, aktorët, moderatorët dhe reporterët e lajmeve gjithashtu angazhohen në marketingun e njerëzve. Vetëm mendoni për fushatat paraelektorale dhe kampanjat e kandidatëve të ndryshëm. Kujtoni menaxherët e këngëtarëve të ndryshëm. Edhe yjet e filmit tanimë kanë personin apo agjencinë për marrëdhënie publike.

- **Vendet.** Me këtë nënkuptohet marketimi i Qyteteve, Komunave, Regjioneve, Shteteve, Liqeve, Maleve etj. Sidomos është karakteristike e vendeve turistike, ta zëmë qytetet bregdetare, qendrat e skijimit që nganjëherë shtrihen edhe në disa shtete, por edhe qytetet si Prizreni apo Lipjani për shkak të Shpellës së Gadimes apo edhe të parkut nacional të Blinajës që frekuentohen nga mijëra turistë si dhe në të hyrat e qytetit ka shumë rol turizmi. Kur ne mendojmë për marketingun e vendit, ne zakonisht mendojmë për destinacionin e pushimeve si Bjeshkët e Nemuna, Brezovica, Malet e Zhegovcit. Megjithatë marketingu i vendit është diçka tjetër. Qytetet, shtetet dhe kombet, të gjithë angazhohen për t'iu ofruar kapacitete akomoduese turistëve, bizneseve dhe banorëve potencial.
- **Përvojat dhe Ngjarjet.** Janë eksperiencat dhe aktivitetet e fituara të kompanisë në treg në fusha të ndryshme, qoftë shërbime apo mallra. Ta zëmë një kompani me eksperiencë në organizimin e panireve, shfaqjet teatrale, përvjetorët, kampionatet sportive, olimpiada, takimet e ndryshme profesionale, etj. Ketu paraqesin eksperiencën e tyre shumëvjeçare dhe të suksesshme Tregtarët mund të sjellin së bashku një kombinim të mallrave, shërbimeve, ideve, informatave apo njerëzve për të krijuar një lloj të përvojave ose një ngjarje të vetme. Shembuj të mirë përfshijnë parqet si Disney World dhe studiot Universale, ngjarjet sportive si Olimpiada ose shfaqjet skenike dhe muzikore si opera dhe një koncert nga Rita Ora.
- **Prona reale ose financiare.** mund të jenë si patundshmëri apo edhe prona financiare (aksionet dhe obligacionet). Edhe pronat shiten dhe blihen andaj

kërkojnë marketing. Shkëmbimi i stoqeve dhe pasuria e pa tundshme të cilat më parë janë tregtuar jashtë rrjetit online përmes agjentëve të pasurive të pa tundshme dhe kompanive investuese tani paraqiten gjithnjë online.

- **Organizatat.** Pothuajse të gjitha organizatat përpiqen për të krijuar imazhe të favorshme në publik jo vetëm për të rritur shitjet por edhe për të gjeneruar emrin e mirë ndaj konsumatorit. Shumë kompani shpenzojnë miliona në promovimin e vetë kompanisë. Por jo vetëm kompanitë, gjithashtu edhe organizatat tjera, si; muzeumet, universitetet, galeritë gjer te organizatat jopfitabile Ne duhet të kemi parasysh se produktet në këtë listë nuk janë reciprokisht ekskluzive. Për shembull, kompanitë që shesin mallra të prekshme pothuajse gjithmonë shesin shërbimet për të plotësuar ofertat e tyre dhe anasjelltas. Organizatat bamirëse në të njëjtën kohë ofrojnë shërbime, idetë dhe informatat që ata i sigurojnë.

Për të plotësuar nevojat e konsumatorëve të tyre, në mënyrë efektive dhe për të përmbushë objektivat organizative, tregtarët duhet të jenë të zgjuar në krijimin e produkteve dhe kombinimin e tyre në mënyra që i bëjnë ato të veçantë nga ofertat e produkteve tjera. Vendimi i konsumatorit për të blerë një produkt ose grup të produkteve para një tjetri është kryesisht një funksion se sa mirë kjo çështje do ti përmbush nevojat e njerëzve dhe kënaq dëshirat e tij ose saj. Ekonomistët përdorin termin shkëmbim për të përshkruar aftësinë e një produkti për të kënaqur dëshirat e konsumatorit. Konsumatorët zakonisht kërkojnë shkëmbime nga tregtarët të cilët ofrojnë produkte që janë të mira ose të “larta” nga aspekti i këtyre pesë llojeve të dobive:

- **Forma e dobishme.** Produktet e mira apo “të larta” nga aspekti i formës kanë attribute apo karakteristika të cilat i diferencojnë ato nga konkurrenca. Këto diferencime rezultojnë nga përdorimi i kualitetit të lartë të lëndës së parë, komponentëve ose nga përdorimi i lartë dhe efikas i procesit të prodhimit. Për shembull

- **Koha e dobishme.** Produktet me nivel të lartë të dobisë në kohë janë në dispozicion kur konsumatorët i duan ato. Kjo nënkupton që produktet janë në dispozicion tani dhe jo më vonë. Dyqanet ushqimore, restorantet dhe shitësit tjerë janë të hapura gjatë gjithë kohës që të sigurojnë dobishmërinë në kohë. Shpeshherë restorantet më të suksesëshme rreth universiteteve janë ato që janë hapur 24/7. Shumë konsumatorë janë gjithashtu të gatshëm të paguajnë më shumë për produktet në dispozicion në një kornizë të shkurtër kohore (siç është shpërndarja në orët e mbrëmjes) ose produktet që janë në dispozicion në kohë më të përshtatshme (siç janë fluturimet ajrore pas mesnate).
- **Vendi i dobishëm.** Produktet e mira nga aspekti i vendit të dobishëm, janë në dispozicion aty ku konsumatori i dëshiron ato. Kjo është tipike për atë që furnizimi bëhet kudo që konsumatori ndodh të jetë në atë moment (si shpërndarja e ushqimit nëpër shtëpi) ose ku produkti duhet të jetë në atë moment (të tillë si luleshitësi në një vend pune). Shpërndarja në shtëpi për ndonjë gjë apo kërkesë (sidomos pica), mallra, shitja e makinave dhe tregtia elektronike, janë shembuj të vendit të dobishëm. Produktet që janë “të larta” në kohë dhe vend të dobishëm janë jashtëzakonisht të vlefshëm për konsumatorët sepse ofrojnë një lehtësi të madhe.
